



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ae.nr. 295/2019

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Rrustem Thaqi, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Kompania e Sigurimeve ["Z..."], me seli në Zurich-Zvicër, të cilën e përfaqëson ["L..."] nga Prishtina, [B.N] - Avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ["K..."], me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson [V.R], për shkak të regresit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.EK.nr.6/18, të datës 1 1.06.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.10.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve ["K..."], me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.EK.nr.6/18, të datës 11.06.2019, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses Kompania e Sigurimeve ["Z..."], me seli në Zurich-Zvicër, ashtu që është detyruar e paditura Kompania e Sigurimeve ["K..."], me seli në Prishtinë, që në emër të regresit mbi bazën e sigurimit auto kasko nga rasti i siguruar i datës 30.04.2016 t'ia paguaj paditëses shumën prej 2,728.00€ me kamate ndëshkuese prej 8% duke llogaritur nga data 01.05.2017, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 1,004.50€, e deri në pagimin definitiv, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura Kompania e Sigurimeve ["K..."], me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktikë dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovon ankesën si të bazuar, dhe të prishet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje

Ekonomike, IV.EK.nr.6/18, të datës 11.06.2019 , dhe lënda ti kthehet gjykatës se shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankese nuk ka.

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, Kompania e Sigurimeve [”Z...”], me seli në Zurich-Zvicër, me datë 03.01.2018, ka parashtruar padi regresi, kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve [”K...”], me seli në Prishtinë, duke i propozuar gjykatës që ta aprovojë në tërësi kërkesëpadinë dhe ta detyrojë që në emër të regresit nga baza e sigurimit kasko t ia paguaj shumën prej 5,531.39€, me kamatë vjetore prej 12%, duke filluar nga data 18.05.2017 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore. Paditësi pas nxjerrës së ekspertizave ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në shumën e përgjithshme prej 2,728.00€.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka gjetur se nga policia e sigurimit kasko me numër ... e me kushtet e përgjithshme të sigurimit të automjetit shihet se automjeti i markës “BMW 520” me [targa ...] është siguruar tek pala paditëse mbi bazën e sigurimit auto kasko, automjeti i tipit “VË Golf” me [targa ...] ka qenë i pajisur me policë valide të sigurimit nga auto përgjegjësia të lëshuar nga e paditura. Nga raporti i aksidentit me numër ... i datës 30.04.2016 të përpiluar nga Policia e Kosovës, si dhe nga provat e tjera të lëndës shihet se gjatë kohës së sigurimit me datën 30.04.2016 ka ndodhur aksident i trafikut në magjistralen Gjilan – Kamenicë në mes automjetit të siguruar auto kasko “BMW 520” me [targa ...] dhe një automjeti tjetër të markës “VW Golf” me [targa ...]. Nga ekspertiza e komunikacionit të punuar nga z. [B.L] të dorëzuar në gjykatë me datën 11.12.2018 konstatohet se deri të aksidenti ka ardhur me lëshimet e dy shofereve të automjetit të përfshira në aksident, ndërsa eksperti i makinerisë z.[N.Sh] në ekspertizën e punuar me datën 19.02.2019 ka konstatuar se riparimi i këtij automjeti nuk është i arsyeshëm ekonomikisht këtë e vërteton fakti se shpenzimet e riparimit sipas kushteve dhe kritereve të regjistruara në Zvicër në vlerën prej 9,068.15€, ndërsa vlera e shpenzimeve të riparimit në Kosovë në shumën prej 7,006.38€ e që janë me të larta se trajtimi si dëm total vlera e cili është 5,456.00€. Kontestuese në këtë çështje ishte lartësia e dëmit, me ç ‘rast pala paditëse kërkon që dëmi të ndahet në përpjesëtim 50 -50% sipas përgjegjësive të pjesëmarrësve në komunikacion e që do të thotë se vlera prej 5,456.00€ kur ndahet në 50% është 2,728.00€, ndërsa pala e paditur kërkon që kësaj vlere ti zbritet edhe shuma prej 1,334.12€ pjesëmarrjen e të siguruarit e që do të mbetet borxhi prej 2,060.40€, lidhur me lartësinë gjykata e shkallës së parë ia ka falur besimin ekspertizës së komunikacionit dhe ekspertizës së makinerisë, ku ka konsideruar se vlera e dëmit është në shumën prej 5,456.00€, ndërsa përgjegjësia lidhur me aksidentin është e barabarte 50- 50%.

Prandaj, gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke u bazuar në dispozitat e Nenit 281, 960 paragrafi 1 të LMD-së, si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 452.1 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 960 par 1 të LMD-së, me të cilin është përcaktuar se *“me pagimin e kompensimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin, në bazë të vetë ligjit, deri në shumën e kompensimit të paguar, të gjitha të drejtat e të siguruarit ndaj personit i cili mbi cilën bazë qoftë është përgjegjës për dëmin”*. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se përgjegjës për dëmin e shkaktuar në aksidentin e datës 30.04.2016, kanë qenë të dy automjetet “BMW” 520” me [targa ...], dhe automjeti “VW Golf” me [targa ...], andaj konform Nenit 18 të Ligjit për Sigurimin e detyrueshëm nga Auopërgjegjësia, është krijuar detyrimi i të paditurës për kompensimin e dëmit, Paditësi ia ka paguar të siguruarit të tij kompensimin e dëmit të pësuar dhe me pagimin e kompensimit të gjitha të drejtat e të siguruarit kanë kaluar të paditësi.

Gjykata Apelit vlerëson së janë përmbushur kushtet për subrogimin e kërkesës në kuptim të nenit 281 të LMD-së ku thekson së *“kur detyrimin e përmbush personi i cili ka ndonjë interes juridik në këtë çështje, atëherë i kalojnë këtij, në bazë të vetë ligjit, në çastin e përmbushjes, kërkesat e kreditorit me të gjitha të drejtat aksesore”*. Po ashtu edhe në nenin 960 paragrafi 1 të LMD-së, ku thekson së *“Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin”*. E drejta e paditësit për subrogimin e kërkesës mbështetet edhe në nenet 25 dhe 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia.

Gjykata e Apelit i vlerësoi pretendimet të palës së paditur, lidhur me atë të paditësi nuk mund të regresoje, ngase Republika e Kosovës nuk është pjesë e këshillit të Byrove, por gjeti se ky pretendim është i pabazuar sepse në rastin konkret objekti i kontestsit është subrogimi, zbatohet dispozitat e Nenit 281 të LMD-së, ndërsa si dispozitë referuese për përcaktimin e natyrës juridike të subrogimit, gjykata i është referuar Nenit 960 të LMD-së. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve me dispozitën e nenit 281 dhe 960 njeh të drejtën në subrogim si kategori e të drejtës subjektive në rimbursim si për personat vendor ashtu edhe për të huajt.

Gjykata e Apelit i shqyrtoj pretendimet ankimore të paditurës se polisa kasko nuk e mbulon territorin e Republikës së Kosovës, mirëpo kjo gjykate gjeti se të njëjtat janë të pabazuara për arsye se sigurimi kasko i të dëmtuarit mbulon edhe territorin e Kosovës. Ne paragrafin A.2.5 të kushtet e përgjithshme për sigurimin e automobilitave “AKB” theksohet se *Kasko sigurimi ju siguron mbrojtje në kufijtë gjeografik të Evropës si dhe vendet jashtë evropian të cilat i takojnë juridiksionit të Bashkimit Evropian*, pra meqenëse Kosova gjendet në kufijtë gjeografike të Evropës, kasko sigurimi i të dëmtuarit e mbulon edhe territorin e Republikës së Kosovës.

Gjykata e shkallës së dytë i vlerësoi pretendimet ankimore të të paditurës lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale me rastin e vendosjes për kamatën prej 8%, mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pabazuara, sepse gjykata e shkallës së parë drejta ka zbatuar dispozitat ligjore me rastin e caktimit të kamatës.

Gjykata i vlerësoi pretendimet tjera ankimore të paditurit, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë e ka zbatuar të ligjin material, ndërsa pretendimet e të paditurit lidhur me mungesën e dokumentacionit për vërtetimin e padësës së dëmit, janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës sepse në shkresa të lëndës gjenden të gjitha provat e përkthyer nga përkthyesi gjyqësor nga të cilat vëretohet se paditësi ai ka paguar të dëmtuarit kompensimin e dëmit.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,

Ae.nr.295/2019, dt.06.10.2020

KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Tutuli, d.y.

